

I nderuar Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave z. Aliu,
I nderuar nënkryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave z. Wright
I nderuar drejtor ekzekutiv i Shoqatës z. Balija
Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare
Të nderuar pjesëmarrës
Zonja dhe zotërinj

Është një kënaqësi e veçantë t'ju drejtohem sot në konferencën vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës, të cilën dëshiroj ta përgëzoj për organizimin si dhe për përzgjedhjen e një teme shumë të rëndësishme në sektorin bankar dhe më gjerë: *“Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme, mundësitë dhe sfidat”*.

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të ketë rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe këtë vit ky sektor ka vazhduar të përmirësojë qasjen në financa për biznese dhe individë, ka përmirësuar kualitetin e aseteve dhe kushtet e kreditimit, duke mbetur kështu sektor i kapitalizuar mirë dhe me profitabilitet. Po ashtu, edhe në këtë vit bankat kanë investuar në kualitetin e shërbimeve bankare përmes teknologjisë dhe inovacionit në avancimin e shërbimeve për klientë.

Gjatë viteve të fundit zhvillimet e hovshme dhe risitë në teknologjinë e informacionit, kanë bërë që të kemi avancim të instrumenteve elektronike në fushën e sistemeve të pagesave, si dhe në infrastrukturën dhe shërbimet financiare në përgjithësi. E ne jemi dëshmitarë të një zhvillimi të shpejtë teknologjik, i cili ka eliminuar kufijtë fizikë dhe ka lehtësuar qasjen në instrumente, shërbime dhe platforma elektronike të pagesave. Në çdo rast, përfshirja e platformave dhe shërbimeve inovative në fushën e sistemeve të pagesave duhet bërë me shumë kujdes, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve të sigurta, efikase, të shpejta dhe të dëshiruara për klientin.

Roli i BQK-së në arritjen e objektivave të saj, kërkon harmonizimin e përpjekjeve me banka dhe institucione që ofrojnë shërbime të pagesave. Prandaj, funksionimi efikas, i sigurt, i shpejtë dhe i qëndrueshëm i sistemit të pagesave, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare

dhe ekonomisë së vendit, është një ndër objektivat parësore të BQK-së. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, BQK-ja angazhohet direkt dhe mbështet në vazhdimësi avancimin e infrastrukturës financiare dhe teknologjike, për të rritur përdorimin e instrumenteve elektronike në mënyrë që të reduktohen transaksionet në para të gatshme.

Banka Qendrore ka treguar përkushtim të vazhdueshëm për këtë fushë dhe brenda kompetencave ka prirë me iniciativa për reduktimin e parasë së gatshme dhe njëkohësisht ka mbështetur bankat dhe institucionet me infrastrukturë të avancuar ligjore, për të lehtësuar përdorimin e instrumenteve elektronike, për rritje të besimit dhe të sigurisë për përdorim të platformave të reja të pagesave. Konkretisht, kjo është arritur:

- Duke hartuar një sërë rregulloresh, udhëzimesh dhe marrëveshesh në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira;
- Duke përsosur dhe automatizuar proceset e kliringut dhe shlyerjeve në Sistemin e Pagesave Nderbankarë të Bankës Qendrore;
- Duke krijuar urat e bashkëpunimit me institucione e kompani vendore dhe ndërkombëtare, për të ndihmuar sektorin financiar në Kosovë;
- Duke krijuar dhe zhvilluar skemat e pagesave (Kos Giro, Debitim Direkt);
- Duke lansuar programin për edukim financiar, sjellje dhe vetëdijesim financiar të klientëve për shërbimet inovative të pagesave, mbrojtjen e konsumatorit, dhe
- Duke organizuar seminare, trajnime dhe takime të rregullta pune për të promovuar skemat e pagesave, për të rritur përdorimin e skemave dhe instrumenteve elektronike, si dhe për të reduktuar transaksionet në para të gatshme.

Po ashtu edhe qeveria me strukturat përkatëse administrative, ka një rol përcaktues në rregullimin e kësaj fushe.

Institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë kontribuar në këtë proces duke i obliguar institucionet financiare dhe bizneset në kryerjen e pagesave dhe të detyrimeve të shërbimeve publike dhe administrative vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

Është për t'u theksuar edhe se bankat komerciale në Kosovë kanë qenë shumë proaktive në drejtim të ndërmarrjes së iniciativave dhe veprimeve për zhvillime të reja dhe përshtatje të

teknologjive më bashkëkohore, të krahasueshme me ato të vendeve të Evropës Perëndimore.

Aktualisht janë aktive afro 2 milionë llogari bankare, 1 milion kartela bankare (debiti dhe krediti), mbi 10 mijë terminale të pikave të shitjes, mbi 500 bankomate, si dhe afro 200 mijë llogari e-banking. Rrjedhimisht, transaksionet përmes instrumenteve elektronike kanë shënuar trend rritës, dhe krahasuar me vitin paraprak është shënuar rritje në vlerë tek transaksionet me kartela në mbi 10% dhe tek transaksionet e-banking në mbi 50%.

Megjithëse të dhënat statistikore tregojnë se ka pasur një rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike në vitet e fundit në Kosovë, krahasuar me vendet e Evropës, indikatorët flasin për një nivel ende të ulët të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave dhe vërehet një hendek mes vendit tonë dhe vendeve të Evropës, ku mbi 80% e të rriturve kanë kartela bankare në përdorim përderisa në Kosovë 50%.

Roli i bankave në këtë drejtim është dhe mbetet i rëndësishëm dhe deri diku i pazëvendësueshëm, për sa i përket edukimit financiar për rritjen e përdorimit të shërbimeve elektronike të pagesave dhe për uljen e nivelit të përdorimit të parasë së gatshme.

Në të vërtetë, të gjithë ne (BQK, bankat komerciale, institucionet qeveritare dhe akterë tjerë), duhet të ndërmarrim iniciativa dhe veprime të vazhdueshme për të rritur transaksionet pa para të gatshme në ekonominë e vendit tonë.

BQK-ja dhe bankat komerciale të vendit kanë hapësirë për të shtuar angazhimin përreth Këshillit Kombëtar të Pagesave për të trajtuar dhe analizuar situatën e tashme, si dhe për t'i planifikuar zhvillimet e ardhshme duke hulumtuar, marrë përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Po ashtu, institucionet tona, përmes projekteve të veçanta dhe veprimtarisë së rregullt mund të intensifikojnë aktivitetet lidhur me kompletimin e infrastrukturës së sistemeve të pagesave.

Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për të thelluar dhe zgjeruar njohuritë financiare të klientëve të bankave. Me çka jo vetëm që do të arrihet një impakt social i lartë, por edhe i

shërbehet edhe vetëzhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarisë bankare përmes produkteve dhe shërbimeve të reja bankare në vend.

Duke pasur parasysh se në sesionet e radhës në këtë konferencë do të diskutohet më në hollësi për mundësitë dhe sfidat për reduktimin e transaksioneve me para të gatshme, mund të nxirren konkluzione me qëllim që të ndërmerren hapa të mëtejme për reduktimin e parasë së gatshme në përdorim.

Po e mbyll fjalën time këtu, duke e ritheksuar vlerësimin e lartë për arritjet e deritanishme në ofrimin e shërbimeve të pagesave elektronike dhe besimin për progres të mëtejme në të ardhmen.

Duke ju përgëzuar edhe një herë për realizimin e konferencës së sotme, ju uroj punë të mbarë.

Faleminderit!